



Për: Mediat e shkruara dhe elektronike
Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun
Subjekti: GP i AKR-së po qëndron për vizitë në Suedi

Prishtinë, 9 maj 2008

Njoftim

Me ftesë të Partisë Popullore Liberale të Suedisë, në Stokholm, po qëndron për vizitë pune, një delegacioni i Grupit Parlamentar të AKR-së, i përbërë nga nënkryetari i AKR-së dhe anëtarë të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, prof. Ibrahim Gashi, deputetët Rita Hajzeraj dhe Suzana Novëbërdaliu.

Në ditën e parë të vizitës, në Parlament dhe Qeverinë Suedeze, deputetët e GP të AKR-së, u pritën nga Ministria për Çështje Evropiane znj. Cecilia Manstrom. Udhëheqësi i delegacionit, z. Ibrahim Gashi, falënderoj Ministrën për mbështetjen që qeveria e Suedisë dhe në veçanti Partia Liberale, i ka dhënë zgjidhjes së çështjes së Kosovës, duke qenë pjesë e grupit, të shteteve të para, që e njohën Pavarësinë e Kosovës.

Ministria, znj Manstrom, nga ana e saj vlerësoi lart angazhimet e spektrit politik të Kosovës, në procesin e definimit të statusit, si dhe rolin konstruktiv të opozitës. Në këtë takim u diskutuan edhe çështjet me prioritet, në lidhje me marrëdhëniet e reja bilaterale mes Kosovës dhe Suedisë, dhe në veçanti, gjatë vitit 2009, kur Suedia do ta ketë Presidencën e radhës në BE.

Ky delegacion kërkoj angazhimin e Suedisë për ndihmë në Konferencën Ndërkombëtare të Donatorëve, dhe rritjen e mundësive për shkëmbime në fushën e edukimit të lartë, si dhe konsulentë profesionale në fushën e ndërtimit të Institucioneve demokratike. Po ashtu, u kërkua edhe mbështetja e liberalëve për anëtarësimin e Partisë Aleanca Kosova e Re në familjen e liberalëve evropianë.

Me këtë rast u konfirmua ftesa që do ti bëhet AKR-së, në Kongresin e ELDR-it gjatë tetorit, në Stokholm.

Gjatë vizitës delegacioni i deputetëve të AKR-së u mirëprit edhe në selinë e Partisë Popullore Liberale, nga sekretari gjeneral z. Erik Ullenhag me të cilin u diskutuan mënyrat më të mira të bashkëpunimit reciprok, me theks të veçantë në ndërkombëtarizimin e AKR-së.

Në të gjitha këto takime, fokus i veçantë ju kushtua edhe zhvillimeve më të reja në Kosovë dhe Rajon.

Për nderë të kësaj vizite, një grup deputetësh i Parlamentit të Suedisë, shtroj drekë pune, të cilën e përcollën edhe mediat suedeze. Kurse, me 9 Maj, me rastin e “Ditës së Evropës”, delegacioni i AKR-së nga Parlamenti i Kosovës, është ftuar për të marr pjesë në ceremoninë e organizuar për këtë ditë, ku, ky delegacion, do t’u drejtohet të pranishmëve, me një fjalë përshëndetëse.

Zyra për Informim e AKR-së